

Dr. Musli Vërbani

Besimi në Zotit

1

Planprogrami i muslimanit të vogël

Hasanah, B.O.N

Autori:

Dr. Musli VËRBANI

BESIMI NË ZOTIN

*Radhitja kompjuterike,
kopertina dhe dizajni grafik*
Mumin Shehu

Shtypi
“FOCUS”

Oslo
2009

Të drejtën e ribotimit e rezervon botuesi

DUA QË MUSLIMANI TË JETË:

1. **A**tëdhetarë
2. **B**esimtarë i singert
3. **C**ilësorë
4. **Ç**lirimtarë
5. i **D**ashur për të gjithë
6. i **Dh**imbshëm për çdo kend
7. **E**dukues i shoqërisë
8. i **Ë**mbël në biseda
9. **F**alenderues i Allahut
10. i **G**ëzuar dhe i lumtur
11. **Gj**eneratorë i të mirave
12. **H**ero në beteja
13. **I**deatorë i zgjedhjes së problemeve
14. **J**etik i veprave të mira
15. **K**reatorë
16. i **L**umtur
17. **L**logaritarë i veprave të tij
18. **M**enjanues i të këqijave
19. **N**dihmëtarë i të varfërve
20. **Nj**erëzorë dhe Humanitarë
21. **O**bjektiv
22. i **P**a thyeshëm si shkëmb
23. **Q**ëndresë si Feniksi
24. **R**evolucionarë
25. **Rr**egullues i marrëdhënieve shoqërore
26. **S**imbol dhe sypatrembur
27. **Sh**embulltyrë për të tjerët
28. **T**ejpamës i problemeve
29. i **Th**jesht dhe modest
30. **U**dhërrëfyes për në rrugën e drejtë
31. **V**ullnetmirë i shoqërisë
32. **X**ixëllonjë i shpresave
33. **Xh**evahir
34. **Y**ll
35. **Z**emërbutë dhe
36. **Zh**dukës i të keqes dhe zhvillues i të mirës

Dr. Musli VËRBANI

**“Lutju Zotit dhe thuaj: “O Zoti im
shtoma diturinë”**

Kuran

**“O Zoti im më pajis me dituri të dobishme,
më jep furnizim të begatshëm,
mi prano veprat e mia”.**

Hadith

(شَهِدَ اللَّهُ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ وَالْمَلَائِكَةُ وَأُولُوا الْعِلْمِ قَائِمًا بِأَلْقَاسِطِ
لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ).

“Allahu dëshmoi dhe vërtetoi se nuk ka zot tjetër përveç Tij, e dëshmuan edhe engjëjt e dijetarët, dhe se Ai është zbatues i drejtësisë. Nuk ka zot përveç Tij Fuqiplotit e të Urtit”.
(Ali Imran, 18)

(لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِّنْ أَنفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُمْ
بِالْمُؤْمِنِينَ رَءُوفٌ رَّحِيمٌ).

“Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vie rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndijshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët”.

(Et-Tevbe, 128)

Hyrje

Nga Umeri radijallahu anhu, transmetohet se ka thënë:
“Një ditë ishim duke ndenjur te i Dërguari i Allahut, s.a.v.s. kur u duk një njeri me rroba shumë të bardha dhe flokë shumë të zeza. Në të nuk hetoheshin shenjat e udhëtimit dhe askush prej nesh nuk e njohëm. U ul pranë të Dërguarit, s.a.v.s. duke i mbështetur gjunjët e vet mbi gjunjët e tij, i vendosi duart e veta mbi mbi kofshën e tij dhe pyeti:

“O Muhamed, më trego ç’është Islami?

Muhamedi a.s. iu përgjigj. Islami është:

- të dëshmosh se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Zotit,
- të falësh namazin,
- ta japësh zekatin,
- ta agjërosh ramazanin,
- ta kryesh haxhin në Kabe, nëse ke mundësi.

Ai pohoi “Të vërtetën e the”. Ne u çuditëm! Po e pyet dhe po ia vërteton.

Pastaj pyeti: Më trego çka është Imani?

Muhamedi a.s. iu përgjigj:

- “Imani është të besosh Zotin,
- Melekët e Tij,
- Librat e Tij,
- Të dërguarit e Tij,
- Ditën e fundit,
- Të besosh në të caktuarit e Tij, të mirës dhe të keqes.

Ai pastaj tha: “Të vërtetën e the”.

- Më trego ç’është Ihsani-Mirësia?

- Muhamedi a.s. iu përgjigj:

“Ta adhurosh Zotin sikur e sheh Atë, sepse, edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai vërtetë të sheh ty”.

Pastaj pyeti: Ç’është çasti i Kijametit?

Muhamedi a.s. iu përgjigj: “Për këtë i pyeturi nuk di më shumë se ai i cili pyet”.

- Më trego mbi shenjat e tij.
- Muhamedi a.s. iu përgjigj:
- “Kur robëresha t’i lind vetes zonjushë
 - kur të shihen barinjtë këmbëzbathur, të zhveshur e të mjerë se si garojnë në ndërtimin e godinave të mëdha. Pastaj shkoi kurse unë mbeta i habitur, e Muhamedi a.s. tha:
“O Umer a e njohe atë që më pyeti”.
 - Allahu dhe i Dërguari i Tij e din më së miri iu përgjigja. Muhamedi a.s. tha: “Vërtet ky ishte Xhibrili, erdhi tua mësojë fenë tuaj”.

(MUSLIMI)

KAPITULLI I PARË

PARIMET E SHEHADETIT

Parimet kryesore të shehadetit janë:

1. Vërtetimi i Ekzistimit të Allahut xh.sh.
2. Vërtetimi i cilësive të Allahut xh.sh.
3. Vërtetimi i veprave të Allahut xh.sh.
4. Vërtetimi i çdo gjëje me të cilat na lajmëroi ose me të cilat u dërgua Muhamedi a.s. prej anës së Allahut xh.sh.

SHARTET E FJALËS “ LA ILAHE IL - LALLAH “

Fjala LA ILAHE IL-LALLAH i ka shartet që d.m.th. se nëse kjo fjalë nuk i plotëson këto sharte, atëherë nuk e ka vlerën e saj të plotë, e ato janë:

1. Me ditë domethënien e kësaj fjale
2. Me qenë i bindur në këtë fjalë
3. Me i kry të gjitha urdhrat dhe me pranuar çdo gjë që ka ardhur prej Allahut nëpërmjet kur'anit dhe hadithit
4. Singëriteti i kësaj fjale
5. Me e dashtë këtë fjalë

Pyetje:

1. *Cilat janë parimet kryesore të shehadetit?*
2. *Cilat janë shartet e fjalës LA ILAHE IL-LALLAH?*

SHARTI I PARË

ME DITË DOMETHËNIEN E FJALËS “LA ILAHE IL - LALLAH”

Ai që e thotë dëshminë LA ILAHE IL-LALLAH duhet ta dijë domethënjen e saj, e domethënia e saj është se çdo adhurim (ibadet) të bëhet vetëm për Allahun i Cili nuk ka shok as rival. p.sh.

- Kur të falemi me u falur vetëm për Allah,
- Kur të agjërojmë, me agjëru vetëm për Allah,
- Kur të japim zekatë, me dhënë zekatë vetëm për Allah,
- Kur të kërkojmë mbështetje, mbështetje me pasë vetëm në Allahun, e në askënd tjetër,
- Kur të kërkojmë ndihmë dhe mbrojtje me kërku vetëm prej Allahut dhe me ju frikësu vetëm Allahut dhe askujt tjetër.

SHARTI I DYTË

ME QENË I BINDUR NË FJALËN “LA ILAHE IL-LALLAH”

Muslimani i vërtetë duhet të jetë i bindur në fenë e tij, ai nuk duhet të ketë asnjë njollë dyshimi në zemrën e tij. Muslimani e di se Allahu është Një. Ai nuk ka lind askënd, nuk ka lind prej askujt, Ai nuk ka shok as rival, Ai nuk i gjason asnjë sendi dhe askujt. Ai sundon gjithçka dhe çdo gjë, qoftë prej gjithësije; prej gjallesave, prej sendeve të gazta, të lëngëta, të ngurta. Të gjitha i nënshtrohen vetëm Atij.

SHARTI I TRETË

ME I KRY TË GJITHA URDHËRAT DHE ME PRANU ÇDO GJË QË KA ARDHUR PREJ ALLAHUT NËPËRMJET KUR'ANIT DHE HADITHIT

Besimtari e don Allahun dhe të dërguarin e Tij, ai nuk i kundërshton urdhërat e Allahut dhe të dërguarit të Tij. Ai në çdo moment, në çdo kohë është i gatshëm me i ndëgju dhe me i kry urdhërat e Allahut.

SHARTI I KATËRT

SINQERITETI I FJALËS “LA ILAHE IL-LALLAH”

Fjalën LA ILAHE IL-LALLAH besimtari e thotë me sinqeritet të plotë; me thellësi të zemrës dhe të shpirtit, me fuqi të mendjes dhe të trupit, kështuqë çdo vepër të mirë që e bën ai, e pret shpërblimin vetëm prej Zotit dhe prej askujt tjetër.

SHARTI I PESTË

VËRTETËSIA E FJALËS “LA ILAHE IL-LALLAH”

Muslimani gjithmonë duhet ta ketë bindjen e fortë në Allahun e Lartëmadhëruar dhe duhet të jetë i fortë në fenë e tij, kështu që duron prej çfardo fatkeqësie që i ndodhë pse e di se ajo fatkeqësi e ka ndodhë si sprovë prej Allahut për me e vërtetu a është besimtarë i vërtetë apo jo i vërtetë. Nëse është besimtarë i vërtetë dhe duron për hirë të Allahut të Lartëmadhëruar do ta shpërblejë me xhenet në botën tjetër.

SHARTI I GJASHTË

ME E DASHTË FJALËN “LA ILAHE IL-LALLAH”

Muslimani i vërtetë e don fjalën “LA ILAHE IL-LALLAH”, ai këtë fjalë e thotë vazhdimisht dhe pandërprerë. Ai vazhdimisht thërret në këtë fjalë, ipërmbahet kësaj fjale dhe gjithmonë angazhohet që kjo fjalë të triumfojë dhe të jetë me e larta dhe superiore.

Muslimani e don atë i cili e thotë këtë fjalë.

Çdo fjalë të cilën e themi prej gjuhës të jetë për Allahun; çdo rrahje e zemrës të jetë për Allahun dhe çdo vepër të cilën e bëjmë me trup e bëjmë vetëm për Allahun e Lartëmadhëruar.

BESIMI NË ALLAHUN xh.sh.

Besimi në Allahun xh.sh. nënkupton të bindurit e plotë se vetëm Allahu është Zot, Krijues i çdo gjëje, Sundues i pakufishëm, se vetëm Ai meriton me u adhuru, se Ai posedon të gjitha cilësitë e përsosshmërisë dhe nuk ka asnjë të metë.

Besimi në Allahun xh.sh. përfshinë tri qështje themelore:

1. TEVHIDË ULUHIJE
2. TEVHIDË RUBUBIJE
3. TEVHIDË ESMAI VE SIFAT

1. TEVHIDË ULUHIJE d.m.th. se çdo nënshtrim, çdo adhurim dhe çdo ibadet i bëhet vetëm Allahut Një.
2. TEVHIDË RUBUBIJE d.m.th. se Allahu është krijues i të gjitha botrave, njëherit sundues, planifikues, udhëheqës dhe dirigjues i të gjitha botrave dhe çdo çështje që është në ta.
3. TEVHIDI ESMAI VE SIFAT d.m.th. se vetëm Allahut i takojnë emrat dhe cilësitë e përsosurisë.

Pyetje:

1. Çka nënkuptojmë me besimin në Allahun?
2. Çka përfshinë besimi në Allahun?
3. Çka d.m.th. TEVHIDË ULUHIJE?
4. Çka d.m.th. TEVHIDË RUBUBIJE?
5. Çka d.m.th. TEVHIDË ESMAI VE SIFAT?

TEVHIDË ULUHIJE

NJËHSIMI I ZOTIT NË VEPRA

TEVHIDI ULUHIJE nënkupton se të gjitha veprat tona të mira me i bë vetëm për hirë të Allahut i Cili nuk ka shok as rival. Nga kjo që thamë kuptojmë se:

- Kur të falemi falemi vetëm për Allahun xh.sh. i Cili nuk ka shok as rival,
- Kur të agjërojmë, agjërojmë vetëm për Allahun xh.sh. i Cili nuk ka shok as rival,
- Kur të japim zekatë, japim vetëm për Allahun xh.sh. i Cili nuk ka shok as rival,
- Kur ta kryejmë haxhin, e kryejmë vetëm për Allahun xh.sh. i Cili nuk ka shok as rival,
- Kur të lutemi, i lutemi vetëm Allahut xh.sh.
- Kur të kërkojmë mbështetje, kërkojmë vetëm nga Allahu xh.sh

Pra çdo vepër qoftë me fjalë, qoftë me zemër, qoftë me trup duhet të jetë vetëm për Allahun e Lartëmadhëruar, e për askë tjetër. Njëhsimi i Zotit në vepra quhet TEVHID ULUHIJE.

Pyetje:

1. Çka nënkuptojmë me Tevhid Uluhiye?

TEVHIDË RUBUBIJE

NJËHSIMI I ZOTIT NË ADHURIM

TEVHIDI RUBUBIJE nënkupton se Allahu xh.sh. krijon, mban, furnizon dhe mbikëqyrë çdo gjë. Pra me këtë kuptojmë se:

1. Allahu i Lartëmadhëruar ka krijuar çdo gjë në qiellëra dhe në tokë, ka kriju njerëzit, kafshët, shpendët, insektet, kodrat, ujërat, diellin dhe hënën.
2. Allahu i lartëmadhëruar furnizon të gjitha gjallesat. Ai i lëvizë dhe i shpërndanë retë që bie shiu në tokë që të mbijnë dhe të rriten pemët e perimet që të ushqehen njerëzit dhe kafshët.
3. Allahu i Lartëmadhëruar ndërron natën dhe ditën. Ai jep vdekje, i bënë që të vdesin gjallesat. Ai përkujdeset dhe mbikëqyrë të gjitha krijesat.

Pyetje:

1. *Çka nënkuptojmë me Tevhid Rububije?*

TEVHIDË SIFAT NJËHSIMI I ZOTIT NË CILËSI

Allahu xh.sh. në Kur'anin fësnik dhe nëpërmjet Muhamedit a.s. e ka cilësu veten e Tij me cilësi të shumta.

Njohja e cilësive të Allahut xh.sh. për mendjen e njeriut është shumë e vështirë sepse mendja nuk mund t'i kuptojë shumë gjëra të fshehta të kësaj bote. E si mund t'i kuptojë gjërat e fshehta të botës shpirtërore?

Cilësitë e Allahut xh.sh. ndahen në dy lloje:

- Cilësi vetanake të Allahut xh.sh. (Sifati Dhatije)
- Cilësitë kuptimore të Allahut xh.sh. (Sifati Meanevije)

Cilësitë vetanake të Allahut xh.sh. (Sifati Dhatije) janë:

1. Vuxhud (EKZISTON)
2. Kidem (I PËRHERSHËM PA FILLIM)
3. Beka (I PËRHERSHËM PA MBARIM)
4. Vahdaniyet (AI ËSHTË NJË)
5. Kijamun binefsihi (EKZISTON NGA VETVETIU) dhe
6. Muhtelifetun lil havadithi (NUK I GJASON ASKUT)

Cilësitë Kuptimore të Allahut xh.sh. (Sifati meanevije) janë:

1. Hajat (JETON)
2. Ilm (DI GJITHÇKA)
3. Semi'ë (NDËGJON GJITHÇKA)
4. Besar (SHEH GJITHÇKA)
5. Irade (I VULLNETSHËM)
6. Kudret (I PLOTFUQISHËM)
7. Kelam (FLET ME TË FOLURIT E TIJ HYJNOR)
8. Tekvin

Pyetje:

1. Si ndahen cilësitë e Allahut xh.sh.?
2. Cilat janë cilësitë vetanake të Allahut xh.sh.?
3. Cilat janë cilësitë kuptimore të Allahut xh.sh.?

CILËSITË VETANAKE TË ALLAHUT (SIFATI DHATIJE)

Cilësitë vetanake të Allahut xh.sh. (Sifati Dhatije) janë:

1. Vuxhud (EKZISTON)
2. Kidem (I PËRHERSHËM PA FILLIM)
3. Beka (I PËRHERSHËM PA MBARIM)
4. Vahdanijet (AI ËSHTË NJË)
5. Kijamun binefsihi (EKZISTON NGA VETVETIU) dhe
6. Muhtelifetun lil havadithi (NUK I GJASON ASKUJT)

VUXHUD (EKZISTON)

E tërë gjithësia dhe çka ka në të si: Qiellërat, toka, kodrat, lumenjtë, bimët, lisat, njeriu, gjallesat dhe të gjitha sendet e ngurta dëshmojnë se EKZISTON (VUXHUD) krijuesi i tyre.

Për këtë dëshmon Zoti i Lartëmadhëruar në Kur'an:

“Allahu është krijues i çdo sendi, Ai është i Vetmi Sundues dhe Triumfues absolut”. (Err-Rread:16)

Pyetje:

1. *Trego ajetin Kur'anorë për krijimin e çdo sendi nga Zoti i Madhëruar që Ai është krijues absolut?*

KIDEM

“I PËRHERSHËM PA FILLIM”

“Allahu ka ekzistuar para çdo sendi dhe para çdo krijese”. Kur kanë shkuar dhe e kanë pyetur Muhamedin a.s. për zanafillën e Allahut xh.sh. ka zbritur sureja “IHLAS” e cila ka këtë domethënie:

Thuj: “Ai, Allahu është Një!

Allahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet për çdo gjë.

As s'ka lindur kë,

As nuk është i lindur.

Dhe Atij askush nuk i është i barabartë”.

Poashtu është edhe një ajet tjetër i cili tregon se Zoti është i përherëshëm pa fillim, se Ai është “EZELIJ”.

“Ai është i Pari (para Tij ska pasur kurr fillim)”. (El Hadid:3)

BEKA

“I PËRHERSHËM PA MBARIM”

Zoti i Lartëmadhëruar sikurse nuk ka fillim poashtu nuk ka as mbarim. Për këtë Zoti xh.sh. në Kur'anin fisnik thotë:

“Ai është i pari që s’ka fillim dhe i fundit që s’ka mbarim, i dukshmi dhe i padukshmi”. (El Hadid:3)

Pyetje:

1. Trego argumentin për cilësinë e Zotit i përhershëm pa fillim?
2. Trego argumentin për cilësinë e Zotit i përhershëm pa mbarim?

VAHDENIJET “ALLAHU ËSHTË NJË”

Zoti i Lartëmadhëruar në Kur'an thotë:

Thuaj: “Ai, Allahu është Një!

Është domosdoshmëri Njëshmëria e Krijuesit. Ai ekiston vetvetiu, dhe çdo gjë i takon Atij. Ai udhëheq çdo send dhe në sundimin e Tij nuk ka shok as rival.

Pyetje:

1. Trego argumentin për cilësinë “Vahdenijet” të Zotit?

KIJAMUN BINEFSIHI

“EKZISTON NGA VETVETIU”

Allahu xh.sh. nuk ka nevojë për askënd, ndërsa krijesat kanë nevojë për Atë. Këtë e dëshmon edhe sureja e shkurtë e Kur'anit:

“ALLAHU SAMED”

“Allahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet, i mbështetet për çdo nevojë. As s’ka lindur kë, As nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i ngjashëm as i barabartë”.

Pyetje:

1. *Trego argumentin për cilësinë e Zotit Kijamun bi nefsihi?*

MUHALEFETUN LIL HAVADITHI “NUK I PËRNGJAN ASKUJT DHE ASGJËHIT”

Zoti i Lartëmadhëruar në Kur'an thotë:

“Askush nuk është si Ai”.

Besimtari beson në Krijuesin, ndërsa është e pamundur që krijuesi me i përngja krijesave. Për këtë arsye është e ndaluar rreptësisht që Allahu xh.sh. të personifikohet me çfarëdo krijese, apo me çfarëdo sendi qoftë – material apo jomaterial.

Pyetje:

1. *Trego argumentin për cilësinë e Zotit Muhalefetun lil havadithi?*

CILËSITË KUPTIMORE TË ALLAHUT xh.sh. (SIFATI MEANEVIJE)

Cilësitë kuptimore të Allahut xh.sh. janë:

1. Hajat (JETON)
2. Ilm (DI GJITHÇKA)
3. Semi'ë (NDËGJON GJITHÇKA)
4. Besar (SHEH GJITHÇKA)
5. Irade (I VULLNETSHËM)
6. Kudret (I PLOTFUQISHËM)
7. Kelam (FLET ME TË FOLURIT E TIJ HYJNOR)
8. Tekvin

Pyetje:

1. *Cilat janë cilësitë kuptimore të Allahut xh.sh.?*

HAJAT

“ALLAHU ËSHTË I GJALLË DHE I PËRJETSHËM”

Zoti i Lartëmadhëruar në Kur'anin fisnik thotë:

“Allahu la ilahe il-la huvel Hajjul Kajjum”.

“Allahu është Një, nuk ka zot tjetër përveç Atij. Ai është mbikëqyrës i përhershëm, i gjallë dhe i përjetshëm”.

El-Bekare:255

Nga ky ajet kuptojmë se gjallëria e Allahut është cilësi esenciale dhe tregon përsosurinë absolute të Tij, e cila dallon nga jeta dhe gjallëria e krijesave.

Pyetje:

1. *Trego argumentin e ajetit Kur'anorë të cilësisë së Zotit EL HAJAT?*

ILM - “DIN GJITHÇKA”

Dituria e Allahut xh.sh. është e pakufishme. Ai din gjithçka, dituria e Tij përfshinë çdo send në esencë.

Dituria e Allahut xh.sh. përfshinë jo vetëm të kaluarën dhe të tashmën, por edhe të ardhmen. Ai i din gjërat nga jashtë dhe nga mbrenda. Ai i din qështjet të cilat shprehen haptazi por edhe ata qështje që mbahen sekrete dhe janë të fshehta.

Për këtë Zoti i Lartëmadhëruar në Kur'anin fisnik thotë:

“Nuk ka dyshim dhe është e vërtetë se Allahu është i dijshëm për çdo send”. El Muxhadele:7

Poashtu Zoti i Lartëmadhëruar në Kur'anin thotë:

“Ai i ka qelësat e të gjitha fshehtësive, ato i di vetëm Ai. E di se çka ka në tokë dhe çka ka në det. Asnjë fletë nuk bie e Ai të mos di për ate. Dhe nuk ka kokërr në mbendësi të tokës, çfardo që të jetë e njomë që binë menjëherë ose e thatë e që ajo të mos jetë në librin e qartë”. El En'amë:59

Pyetje:

1. *Trego argumentin Kur'anorë për cilësinë e Zotit se Ai din gjithçka ?*

SEM'Ë (DËGJON)

Çdo fjalë e cila flitet nuk mund ta ndëgjojë askush tjetër para Zotit xh.sh. Allahu ndëgjon çdo lëvizje, e çdo qetësi.

Te Allahu xh.sh. nuk vjen në pyetje largësia apo afërsia e ndëgjimit, lindje e perendim, veri a jug. Ngase zëri edhe pse e ka shpejtësinë për të kaluar një kohë prej një vendi në vend tjetër, Zoti i Lartëmadhëruar e ndëgjon në çdo moment.

Zoti i Madhëruar këtë e tregon në Kur'an:

“Vërtetë, Allahu dëgjoj fjalët e asaj e cila bisedoi me ty lidhur me burrin e vet, që u ankua te Allahu; prandaj Allahu e dëgjon bisedën tuaj, Allahu dëgjon çdo bisedë dhe e sheh çdo punë”. (El Muxhadele:1)

Pyetje:

1. *Trego argumentin Kur'anor të cilësisë së Zotit SEM'Ë (Dëgjon)?*

BESAR (SHIKON)

Sikurse Zoti i Lartëmadhëruar dëgjon gjithçka ai sheh gjithçka. Zoti i Lartëmadhëruar sheh edhe në errësirat më të thella ku nuk mund të sheh askush. Zotit të Lartëmadhëruar nuk i nevojitet drita për të parë, apo teleskop ose mikroskop për të vërejtur gjërat e imta apo të largëta.

Kur shkoj Musa a.s. me vëllaun e tij Harunin te Firauni, ata u frikësuan se ndoshta do t'ju ndodhë ndonjë e keqe, por Zoti i Madhëruar u tha:

“Mos u frikësoni, Unë jam me ju gjithashtu: Ndëgjoj dhe shoh”. (Ta Ha:46)

Nëse të gjithë njerëzit dhe të gjitha gjallesat, organizohen që së bashku të shohin tërësinë e tokës nuk munden me përfshi.

Për këtë arsye mirësi (IHSAN) quhet me adhuru Allahun sikur që e sheh Atë, pse nëse ti nuk e sheh, Ai (Allahu) të sheh ty.

Fëmijë të dashur kështu na ka mësuar mësuesi i njerëzimit Muhamedi a.s.

Pyetje:

1. *Trego argumentin Kur'anor për cilësinë e Zotit El-Besar (Shikon)?*

IRADE (I VULLNETSHËM)

Të gjitha pemët dhe perimet rriten, zhvillohen dhe japin fryte prej elementeve të njejta. Të gjitha kanë: një ajër, një tokë një ujë dhe të gjitha thithin elementet e njëjta të tokës si Karbonin, oksigjenin, hidrogjenin, azotin, fosforin, qibritin, magneziumin, hekurin. Mirëpo kur të shohim molla e ëmbël, limoni e thartë, ndërsa barishta e idhët. Në anën tjetër therra të therron, ndërsa pambuku i butë. Gruri sjell miellin ndërsa lulja e diellit tlynin (yndyrën).

Të gjitha këto dëshmojnë për dëshirën dhe vullnetin (IRADE) të Allahut; se Ai cakton ligjet, rregullon çështjet, frymëzon si don dhe kur të dëshiron. Kjo cilësi absolute nuk i takon askujt tjetër përpos Allahut xh.sh. E nëse Ai dëshiron të gjitha mund t'i ndryshon.

“Zoti yt vërtetë vepron si dëshiron dhe çka dëshiron”.

El Hudë:107

“Zoti yt krijon çka dëshiron dhe zgjedhë. Ju dhe çdo kush tjetër nuk ka zgjedhje”.

El Kasas:68

Pyetje:

1. *Trego argumentin Kur'anorë për cilësinë e Zotit se EL-IRADE?*

KUDRET (I PLOTFUQISHËM)

E tërë gjithësia dhe çdo send që lëvizë, qarkullon ose nuk lëvizë është me fuqinë (KUDRETIN) e Allahut xh.sh. Fara e grurit e dobët e cila prej toke shpërthen dhe rritet, rritet me plotfuqinë (KUDRETIN) e Allahut xh.sh.

Erërat të cilat puhitin, dhe retë të cilat lëvizin, lëvizin me plotfuqinë e Allahut xh.sh. Lumenjtë të cilët qarkullojnë dhe valët e detit të cilat valojnë, të gjitha janë prej plotfuqisë (KUDRETIT) të Allahut xh.sh. Edhe planetet e yjet në qiell të cilat lundrojnë në horizont dhe në gjithësi, lundrojnë me plotfuqinë (KUDRETIN) E Allahut xh.sh. Sepse Ai ka mundësi-plotfuqi mbi çdo send.

Për këtë Zoti i Lartëmadhëruar në Kur'an na ka mësuar t'i themi Atij:

“Ti (O Zot) vërtetë ke mundësi dhe plotfuqi (KADIRË) mbi çdo send”. Et Tahrimë:8

Pyetje:

1. *Trego argumentin Kur'anorë për cilësinë e Zotit EL-KUDRET?*

KELAM

“FLET ME TË FOLURIT E TIJ HYJNOR”

Të folurit është mjet i sqarimit të qështjeve.
Të folurit e Krijuesit nuk i gjason të folurit të krijesave të cilat burojnë prej buzëve, gjuhës, fytit dhe dhëmbëve. Por të folurit e Zotit është cilësi e posaqme me të cilën Zoti i Lartëmadhëruar u ka folur melaqeve, krijesave e gjithçka ka në qiellëra e në tokë.
Për këtë Zoti i Lartëmadhëruar thotë:

“Thuaj: Sikur deti të jetë ngjyrë për t’i shkruar fjalët e Zotit tim do të shpenzohej ngjyra e nuk do të shpenzoheshin fjalët e Zotit tim edhe nëse prap sjellim ngjyrë sa ka deti”.

El Kehf:109

Në një ajet tjetër thotë Zoti i Lartëmadhëruar:

“Sikurse çka ka në tokë prej lisave të ishin lapsa dhe detit meja bashkangjitë edhe shtat detëra të tjerë, prapseprap fjalët e Allahut nuk shpenzohen. Vërtet Ai është i Fuqishëm dhe i Urtë”.

Lukman:27

Zoti i Lartëmadhëruar ka folur me Musa a.s., ka folur me Xhibrilin, e do të flas edhe me besimtarët në ditën e Kijametit. Ndërsa në këtë botë të folurit e Zotit me robërit e Tij e ka plotësu në Kur’anin Fisnik ku thotë:

“Dhe u plotësua fjala e Zotit tënd e vërtetë dhe e drejtë, nuk mund askush t’i ndryshojë fjalët e Tij, se Ai Dëgjon dhe është i Dijshëm”.

Pyetje:

1. *Trego argumentin Kur’anorë për cilësinë e Zotit EL-KELAM?*

TEVHID ESMA “NJËSIMI I ZOTIT NË EMRA”

Zoti i Lartëmadhëruar në Kur'an thotë:

“Allahu i ka emrat më të bukur, Thirreni me ato emra”.

Poashtu edhe Muhamedi a.s. thotë:

“Allahu i ka 99 emra. Kush i mëson dhe është i bindur, do të hyjë në xhenet”. (Mutefikun alejhi)

Emrat e bukur të Allahut janë:

- ALLAH - Emër i përveçëm i Zotit xh.sh.
- ERR-RAHMAN - Veçori e posaqme e Allahut i cili mëshiron në këtë botë në përgjithësi - besimtarët dhe pabesimtarët
- ERR-RAHIMË - Veçori e posaqme e Allahut i Cili mëshiron posaqërisht vetëm besimtarët në këtë botë dhe në botën tjetër.
- EL-MELIK - Ai sundon me pozitën e Tij si dëshiron.
- EL-KUDDUS - Ai është i pastërt dhe larg ndaj çdo të mete apo mangësie.
- ES-SELAM - Ai është që jep paqë për krjesat.
- EL-MUËMIN - Ai është besnik në premtimet e Tija për shpërblimin e besimtarëve dhe dënimin e pabesimtarëve.
- EL-MUHEJMIN - Ai mbizotëron në mënyrë absolute çdo gjë.
- EL-‘AZIZË - Ai është i plotfuqishëm , gjithmonë Triumfues dhe çdo gjë i nënshtrohet vetëm Atij.
- EL-XHEBBAR - Ai është i gjithëfuqishëm dhe me përpikëri i ekzekuton dhe i realizon qështjet e Tij.
- EL-MUTEKEBBIR - Ai është i Madhërishmi.
- EL-HALIK - Ai është që ka krijuar të gjitha krijesat.
- EL-BARI - Ai është që ka krijuar çdo gjë prej asgjëje, dhe çdo send e ka zanafillën te Ai.

- EL-MUSAVVIR - Ai është që secilit ia ka dhënë formën, figurën dhe veçoritë me u dalluar prej të tjerëve. Ai

	ka formësu me dëshirën e Tij të gjitha krijesat.
EL-GAFFAR	- Ai është që falë vazhdimisht dhe pandërprerë.
EL-KAHHAR	- Me fuqinë e Tij, Ai mbizotron dhe mposhtë çdo send dhe sundon në mënyrë absolute.
EL-VEHHAB	- Ai ju jep të gjitha të mirat robërve të Tij. Ai është bujarë, Ai dhuron çdo begati për të cilën kanë nevojë robërit e Tij.
ERR-RREZAK	- Ai furnizon të gjitha krijesat me çdo gjë çka u nevojitet atyre.
EL-FETTAH	- Ai qliron çdo gjë, Ai zgjedhë çdo qështje dhe Ai sundon gjithçka.
EL-‘ALIMË	- Ai është i gjithëditur.
EL-KABID	Ai është që furnizimin e ka në dorëne Tij dhe ia ngushton kujt dëshiron.
EL-BASIT	- Ai është që furnizimin e ka në dorëne Tij dhe ia zgjeron kujt dëshiron.
EL-HAFID	- Ai është që kriminelët dhe të padrejtët i përul dhe i nënshtrojnë.
ERR-RAFI’Ë	- Ai është që i ngritë në pozita të merituar besimtarët dhe të drejtët.
EL-MU’IZ	- Ai është i robërve të Tij, u jep nderë dhe krenari.
EL-MUDHIL	- Ai është që kë të don e përul dhe e degradon
ES-SEMI’Ë	- Ai është që ndëgjon pakufi.
EL-BASIRË	- Ai është që sheh gjithçka.
EL-HAKEM	- Ai gjykon me drejtësi në mes të robërve.
EL-‘ADL	- Ai është i drejti absolut.
EL-LETIFË	- Ai është i butë ndaj robërve të Tij.
EL-HABIRË	- Ai është i informuar në përpikëri për të gjitha qështjet.
EL-HALIMË	- Ai nuk shpejton në denim, por denon në kohën që e cakton Ai vet.
EL-ADHIMË	- Ai është më Madhështori.
EL-GAFURË	- Ai i cili falë robërit e Tij për gabimet e bëra.
ESH-SHEKURË	- Ai është Mirënjohës dhe i shpërblen besimtarët kur e falënderojnë.

EL-‘ALIJJ	- Ai është më i Larti.
EL-KEBIRË	- Ai është më i Madh sa që mendja e njeriut nuk mund ta paramendojë sa është i Madh.
EL-HAFIDHË	- Ai është Ruajtës absolut sa që Atij asgjë nuk mund t’i shpëtojë kurrë.
EL-MUKITË	- Ai di gjithçka për krijesat.
EL-HASIBË	- Ai llogaritë çka kanë nevojë robërit e Tij dhe u jep çka kanë nevojë.
EL-XHELILË	- Ai është më Fisniku dhe më i Nderuari.
EL-KERIMË	- Ai është më Bujari dhe më Fisniku
ERR-RREKIBË	- Ai vigjilon çdo gjë dhe nuk mund t’i mungojë asgjë.
EL-MUXHIBË	- Ai i pranon lutjet e robërve të Tij.
EL-VASI’Ë	- Ai është Gjithëpërfshirës dhe i zgjeron me furnizimin e Tij të gjitha krijesat.
EL-HAKIMË	- Ai është i Urtë i Ditur dhe Qeverisë me urtësi.
EL-VEDUDË	- Ai ju do të mirën robërve të Tij dhe ju sjellë të mira.
EL-MEXHIDË	- Ai i cili meriton kulminacionin e çdo Lavdërimi dhe Madhërimi.
EL-BA’ITH	- Ai i cili i ringjallë krijesat pas vdekjes së tyre.
ESH-SHEHIDË	- Dituria e Tij është e pakufishme dhe Ai është Dëshmitarë i çdo çështje.
EL-HAKK	- Ai është i Vërteti dhe i Pamohueshmi.
EL-VEKILË	- Ai përkujdeset për furnizimin e robërve të Tij dhe të gjitha krijesave.
EL-KAVIJJ	- Ai ka fortësi dhe fuqi absolute.
EL-METINË	- Ai është i fortë dhe i pathyeshëm.
EL-VELIJJ	- Ai ka në brojtjen e Tij gjithçka.
EL-HAMIDË	- Ai meriton Lavdërim e Falenderim gjithmonë.
EL-MUHSI	- Ai është njohës i përpiktë i çdo çështjeje.
EL-MUBDI	- Ai ka krijuar gjithçka prej asgjëje dhe zanafilla e gjithçkaje është prej Tij.
EL-MU’IDË	- Ai i rikrijon gjërat pasi të humbin dhe të zhduken.

EL-MUHJI	- Ai ju ka dhënë jetë çdo gjallese.
EL-MUMITË	- Ai ua merr jetën çdo gjallese.
EL-HAJJ	- Ai ka gjallërinë dhe jetë absolute.
EL-KAJJUMË	- Ai është i përjetshmi dhe i përgjithmonshmi
EL-VAXHID	- Ai është i pavarur dhe çdo gjë varet prej Tij.
EL-MAXHID	- Ai është i vetmi që meriton lavdata.
EL-VAHID	- Ai është i vetmi, nuk ka zot tjetër pos Tij.
ES-SAMED	- Vetëm Atij i mbështetet gjithçka, dhe vetëm Ai mbron dhe ka në kompetencën e Tij gjithçka.
EL-KADIR	- Ai ka mundësi dhe fuqi absolute.
EL-MUKTEDIR	- Ai është i fuqishëm mbi gjithçka.
EL-MUKADDIM	- Ai gradon cilin të dojë.
EL-MUEHHIR	- Ai degradon cilin të dojë.
EL-EVVEL	- Ai është i pari pa fillim.
EL-AHIR	- Ai është i fundit pa mbarim.
EDH-DHAHIR	- Ai është i dukshëm me veprat e Tij.
EL-BATIN	- Ai është i padukshëm.
EL-VALIJ	- Ai është Sundimtarë dhe Udhëheqës absolut.
EL-MUTE'ALI	- Ai është i Gjithëllartësuari.
EL-BERR	- Ai bën dobi të pandërprerë dhe jep të mira të shumta dhe të panumërta.
ET-TEVVAB	- Ai i pranon tevbet dhe fal gabimet.
EL-MUNTEKIM	- Ai me meritë ndëshkon ndëshkimtarët.
EL-AFUVV	- Ai falë gabimet dhe nuk dënon atë i cili nuk meriton dënimin.
ERR-RREUFË	- Ai është i butë dhe i mëshirshëm ndaj robërve të Tij. Ai është i dhimbshëm ndaj robërve të Tij.
MALIKUL	Ai është Sundimtarë absolut.
MULK-	
DHUL XHELALI	Ai është specifik me cilësitë e Tij
VEL IKRAM -	madhështore dhe është i përsosur . Vetëm Atij i takojnë nderimet.
EL-MUKSIT	- Ai është i drejtë në gjykim.

EL-XHAMI'Ë	- Ai është që i tubon krijesat në ditën e Kijametit.
EL-GANIJ	- Ai është i pavarur dhe çdo gjë varet prej Tij.
EL-MUGNI	- Ai i jep pasuri kujt të dojë.
EL-MANI'Ë	- Ai pengon kur të dojë dhe çka të dojë.
ED-DARRË	- Ai i dëmton të padrejtë dhe të padëgjueshmit.
EN-NAFI'Ë	- Ai i bën dobi të drejtëve dhe të dëgjueshmëve.
EN-NURË	- Ai udhëzon në dritë të vërtetë.
EL-HADI	- Ai udhëzon në rrugë të drejtë dhe të dobishme
EL-BEDI'Ë	- Ai i ka shpikur krijesat dhe i ka krijuar.
EL-BAKI	- Ai është i përhershëm pambarim.
EL-VARITH	- Pasi të shkatërrohen dhe të zhduken krijesat Ai trashëgon gjithçka.
ERR-RRESHIDË	- Ai shpie në rrugë të dobishme.
ES-SABURË	- Ai është durimtarë dhe të padëgjueshmit i dënon në kohë të caktuar.

Pyetje:

1. Trego numrin e emrave të Allahut sipas hadithit të Muhamedit a.s.?
2. Përmendi 20 emra prej emrave të Zotit?

KAPITULLI I DYTË

AI ËSHTË ALLAHU
I CILI NUK KA SHOK AS RIVAL

**NUK ËSHTË I LINDUR
DHE NUK KA LINDË
NUK I GJASON ASGJË ATIJ
KRIJUESI I ÇDO SENDI
KA MUNDËSI PËR GJITHÇKA
ÇOFTË I LARTËSUAR
NA SHEH E NE NUK E SHOHIM
TË TIJ JANË GJITHÇKA KA
NË QIELLËRA DHE NË TOKË
FALË GABIMET
PRANON TEVBEN
POR EDHE DENON ASHPËR
AI NA KA KRIJU
NA FURNIZON
NA KA DHËNË JETËN
NA BËNË TË VDESIM
CILINDO E FURNIZON PAKUFI
NUK ADHUROJ ASKEND POS TIJ.**

EBU HANIFJA DHE ATEISTI

Një ditë prej ditëve një ateist shkon te Halifja i muslimanëve dhe i thotë me guxim se ai është ateist dhe ai dëshiron të bisedojë me dijetarë për ta bindur, sepse ai mendonte se nuk ka Zot.

Halifja heshti pak kohë dhe mendoi në vehte: Nëse e mbytë do të thonë njerëzit – ja nuk kanë qenë në gjendje me diskutu për ta

bindur dhe për atë e ka mbytur. Kështu e thirri ministrin e i tha: Shko thirr Ebu Hanifen.

Pas një kohe arriti Ebu Hanifja. Halifja i tregoi për ateistin dhe i tha që të bisedojë me të dhe ta bindë atë për ekzistimin e Zotit.

Ebu Hanifja i tha Hlifes : Unë do t'i sjelli ateistit argumente për ekzistimin e Zotit por nëse më lejoni pak kohë që të shkoj në një vend se e kam një punë për ta kryer pa tjetër dhe shumë shpejtë do të kthehem.

Halifja e lejoi dhe shkoi.

Koha kaloi, Ebu Hnifja u vonua shumë ndërsa ateisti me kryelartësi i tha Halifes: Më lejoni edhe mua të shkoj pse Ebu Hanifja iku dhe nuk do të kthehet, sepse ai nuk ka argument për të më bindur.

Dhe posa u nis ateisti në drejtim të derës për të shuar kur hyri Ebu Hanifja dhe kërkoi falje për vonesën dhe u tregoi atyre se gjat rrugës kishte për ta kaluar një lum, mirëpo nuk kishte anije dhe është ulur buz lumit për të pritur mos po kalon ndonjë anije dhe kishte pritur shumë derisa befasisht e kishte parë Ebu Hanifja një çështje të quditshme. Kishte parë dërrasat se si vetvetiu bashkoheshin në mes veti në lum, ndërsa gozhdat fluturonin dhe i gozhdonin dhe i përforconin dërrasat dhe çekiçi vetvetiu shkante dhe i mëshonte secilës gozhdë. Kështu derisa barka u ndërtu dhe pa askend mu afura buz lumit ku isha unë për të hypur.

Qeshi me të madhe ateisti dhe tha: Kjo është e pamundur, kjo është e pavërtetë, ti je i çmendur nuk të beson askush. Po si është e mundur që gozhdat të fluturojnë në ajër dhe dërrasat me u bashkuar në ujë vetvetiu dhe me u ndërtu barka.

Ebu Hanifja buzëqeshi dhe i tha: Pasi që një barkë e vogël nuk mund të ndërtohet pa ndërtuesin e saj dhe nuk beson askush, atëherë, si mund të besohet që kjo gjithësi me gjithëçka ka si : toka, qielli, dielli, hëna, planetetë gjitha janë krijuar vetvetiu dhe nuk i ka kriuar askush!?

Ateisti uli kokën pastaj tha: Ke thënë të vërtetën. Kjo gjithësi, patjetër ka krijuar i cili e ka kriuar dhe e ka programuar, e ai është Zoti xh.sh.

MËSUESI PA MEND

Na ishte në një shkollë një musues. Ai nuk besonte në ekzistimin e Zotit. Një ditë prej ditëve mësuesi hyri në klasë dhe i pyeti nxënësit:

- A më shihni?
- Po, të shohim – i thanë nxënësit.
- Pra unë ekzistoj. Pastaj pyeti.

- A e shihni dërrasën e zezë?
- Po iu përgjigjën nxënësit.
- Pra edhe dërrasa e zezë ekziston.
- A i shihni bankat?
- Po i shohim bankat.
- Pra edhe bankat ekzistojnë.

Pastaj i pyeti:

- A e shihni Zotin?
- Jo iu përgjigjën nxënësit.
- Atëherë, ku është Zoti pasi ne nuk e shohim?

Njëri prej nxënësve i cili i shte i zgjuar ungrit në këmbë dhe i pyeti nxënësit:

- A e shihni mendjen e mësuesit?
- Jo iu përgjigjën nxënësat.
- Atëherë mësuesi nuk paska mend!

MËSUESI I MENQUR

Mësuesi i mençur i mori katër molla dhe i shpërndau në katër nxënës dhe u tha:

Merrini mollët dhe shkoni në ndonjë vend ku nuk ju sheh askush.

- I pari shkoi dhe e ngrëri mollën nën shtrat.
- I dyti shkoi dhe e ngrëri mollën pas dollapit.

- I treti shkoi në dhomë dhe e mbyll derën me qelës dhe e ngrëri i vetmuar në dhomë.
- I katërti u kthye me mollë në dorë dhe i tha mësuesit: “Nuk munda të gjej vend ku nuk më sheh askush, pse më sheh Allahu.
- Mësuesi e falenderoi nxënësin dhe e shpërbleu për provimin e dhënë dhe u tha nxënësëve tjerë:
- Ju kam thënë që ta hani mollën ku nuk ju sheh askush. Po pse nuk e ditët se Allahu ju sheh juve gjithmonë në çdo kohë dhe në çdo vend?

BIJA E MENÇUR

Halifja i muslimanëve Omeri r.a. një natë prej netëve ecte nëpër rrugë për t’i shiku nevojat e muslimanëve. Kur papritmas e ndëgjon zërin e një nëne duke i thënë bijes së saj: Shko sjell ujë që ta përziejmë me qumësht, që të kemi sasi më të madhe të qumështit për ta shitur në treg. Mirëpo e bija nuk e dëgjo.

Nëna i tha bijës: Po Halifja nuk na sheh në këtë natë.

Bija ju përgjigj: Nëse Omeri nuk na sheh, atëherë Allahu ëahtë Ai i cili na sheh.

Omeri u gëzua me këtë përgjigjeje të vajzës besimtare e sinqert dhe e martoi me birin e tij.

BILALLI r.a.

Shoku i Muhamedit a.s. Bilalli r.a. ishte rob i Umeje bin Halefit kur e ka pranuar islamin.

Kur dëgjoji idhujtari Umej bin Halef se rob i tij është bërë musliman ka tentuar me e larguar prej besimit por nuk ia ka arritur qëllimit.

Për këtë arsye e merr Bilallin r.a. dhe e dërgon në shkretëtirë në mes të ditës, kur dielli përcëllonte. Aty e zdash lakuriq dhe i vendosë gurë të mëdhenjë në trupin e tij dhe e torturon pa mëshirë. Mirëpo imani i Bilallit vetëm sa shtohet dhe me guxim të madh pandërprerë thonte:

Allahu është Një, Allahu është Një, Allahu është Një.

Dhe kështu në mes të shkretëtirës, në mes të ditës nuk dorëzohej derisa e bleu shoku i Muhamedit a.s. – Ebu Bekri Sidiki dhe e liroi.

Pastaj Bilalli është bërë Muezini i parë në islam.

IMANI – BESIMI NË ZOTIN

Muhamedi a.s. ka thënë:

“Kush thotë LA ILAHE IL-LALLAH do të hyjë në xhenet”.

Kjo fjalë është fjala më madhështore që ekziston.

Shahadeti, i cili tregon njësimin e Zotit, është shkalla më e larta e imanit dhe dega më specifike.

Muhamedi a.s. ka thënë:

***“Imani i ka gjashtëdhjetë e disa degë më e larta është fjala
LA ILAHE IL-LALLAH”.***

Me këtë fjalë hynë në islam. Shahadeti është shart i islamit dhe rukn i tij.

Tani do t’i përmendim edhe degët tjera të imanit:

- | | |
|-------------------------------------|--|
| 1. Maturia në shpenzim | 21. Turpërimi |
| 2. Mbrojtja e pasurisë | 22. Dashuria ndaj të dërguarit |
| 3. Ndalimi i vetëvetes nga vrasja | 23. Rrespekti i të dërguarit a.s. |
| 4. Ndalimi i vetëvetes nga harami | 24. Liximi i Kur’anit. |
| 5. Dashuria në emër të Allahut | 25. Kërkimi i diturisë |
| 6. Urrejtja në emër të Allahut | 26. Përhapja e diturisë |
| 7. Devotshmëria | 27. Drejtësia |
| 8. Largimi i gjërave të dëmshme | 28. Bëmirësia ndaj prindërve. |
| 9. Largimi nga kufri | 29. Edukata e mirë. |
| 10. Falja e namazeve farze | 30. Ndërlidhshmëria fafëfisnor |
| 11. Zekati | 31. Pajtimi mes njerëzve. |
| 12. Haxhi | 32. Edukimi i fëmijëve. |
| 13. Agjnimimi | 33. Me fitu ushqimin hallall. |
| 14. I’ëtikafi | 34. Me shpenzu pasurinë në vende të lejuara. |
| 15. Afrimi me besimtarë | 35. Gëzimi për të mira. |
| 16. Largimi i ndyrësirave nga rruga | 36. Ndalimi nga e keqja |
| 17. Kënaqësia me caktimin e Zotit | 37. Me iu përmbajtë ehli xhematit. |
| 18. Durimi | 38. Bashkimi në të mirë. |
| 19. Mëshira | 58. Shpresa në Zotin. |
| 20. Lutja | 59. Mbështetja në Zotin. |
| 39. Ndëgjimi i udhëheqësave. | 60. Falënderimi për të mirat e Zotit. |
| 40. Plotësimi i premtimit. | 61. Përkujtimi i Zotit. |
| 41. Kefareti. | 62. Ruajtja e gjuhës. |
| 42. Kryerja e akteve. | 63. Pastrimi truporë dhe shpirtërorë |
| 44. Xhihadi. | 64. Ekzekutimi i ligjeve. |
| 43. Dorëzimi i emaneteve. | |
| 45. Ndërlidhshmëria. | |
| 46. Besimi në të dërguarit. | |
| 47. Besimi në librat e Zotit. | |

49. Besimi në caktimin e Zotit.
48. Besimi në melaqet e Zotit.
50. Besimi në ditën e Gjykimit
51. Modestia.
52. Xhelozia
53. Fisnikëria.
54. Rrespektimi i të madhit.
55. Me dëshirue për tjetrin çka
dëshiron për veten.
56. Me e dashur Allahun.
57. Frika ndaj Zotit.

65. Rrespektimi i fqit.
66. Kthyerja e selamit.
67. Vizita e të sëmuarit.
68. Rrespektimi i mikut.
69. Përshëndetja e të teshurit.
70. Me i largu të këqijat të
cilati pengojnë njerëzit
71. Sjellja e mirë ndaj fëmijëve
72. Fshehja e gabimeve.
73. Lutja për të vdekurit.

SURETUL - IHLAS

BISMIL-LAHIRR-RAHMANIRR-RAHIM

KUL HUVALLAHU EHAD
ALLAHU SAMED
LEM JELID
VE LEM JULED
VELEM JEKUN LEHU KUFUVEN EHAD

(قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ . اللَّهُ الصَّمَدُ . لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ .
وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ).

“Thuaj: Ai, All-llahu është Një! All-llahu është Ai të Cilit
çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. As s’ka
lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe me Atë askush nuk i
është e barabartë”. (Suretul – Ihlas:1-4)

AJETUL KURSIJA

BISMIL-LAHIRR-RAHMANIRR-RAHIM

ALLAHU LA ILAHE IL-LA HUVE
EL HAJJUL KAJJUME
LA TEËHUDHUHU SINETUN VE LA NEVM
LEHU MA FIS-SEMAVATI VE MA FIL ERD
MEN DHËL-LEDHI JESHFEU INDEHU IL-LA BI IDHNIHI
JEA’LEMU MA BEJNE EJDIHIM VE MA HALFEHUM

VE LA JUHITUNE BISHEJ IN MIN ILMIHI
 IL-LA BIMA SHAE
 VESIA KURSIJUHUS SEMAVATI VEL ERD
 VE LA JEUDUHU HIFDHUHUMA
 VE HUVEL ALIJJUL ADHIMË.

(اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ لَا تَأْخُذُهُ سِنَةٌ وَلَا نَوْمٌ لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِّنْ عِلْمِهِ إِلَّا بِمَا شَاءَ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ).

“Allahu është një, nuk ka zot tjetër përveç Atij. Ai është mbikëqyrës i përhershëm dhe i përjetshëm. Atë nuk e kap as kotje as gjumë, gjithçka ka në qiej dhe në tokë është vetëm e Tij. Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai, pos me lejën e Tij, e di të tashmen që është pranë tyre dhe të ardhmen, nga ajo që Ai di, tjerët dinë vetëm aq sa Ai ka dëshiruar, Kursija e Tij (dija-sundimi) përfshinë qiejt dhe tokën, kujdesi i Tij ndaj të dyjave, nuk i vjen rëndë, Ai është më i larti, më i madhi”.
 (Suretul – Bekare:255)

PËRMBAJTJA

Hyrje	6
KAPITULLI I PARË	
PARIMET E SHEHADETIT	9
SHARTET E FJALËS “ LA ILAHE IL - LALLAH “	9
SHARTI I PARË -ME DITË DOMETHËNIEN E FJALËS “LA ILAHE IL - LALLAH”	10
SHARTI I DYTË -ME QENË I BINDUR NË FJALËN “LA ILAHE IL-LALLAH”	10

SHARTI I TRETË -ME I KRY TË GJITHA URDHËRAT DHE ME PRANU ÇDO GJË QË KA ARDHUR PREJ ALLAHUT NËPËRMJET KUR'ANIT DHE HADITHIT	11
SHARTI I KATËRT -SINQERITETI I FJALËS “LA ILAHE IL-LALLAH”	11
SHARTI I PESTË -VËRTETËSIA E FJALËS “LA ILAHE IL-LALLAH”	12
SHARTI I GJASHTË -ME E DASHTË FJALËN “LA ILAHE IL-LALLAH”	12
BESIMI NË ALLAHUN xh.sh.	13
TEVHIDË ULUHIJE -NJËHSIMI I ZOTIT NË VEPRA	14
TEVHIDË RUBUBIJE -NJËHSIMI I ZOTIT NË ADHURIM	15
TEVHIDË SIFAT -NJËHSIMI I ZOTIT NË CILËSI	16
CILËSITË VETANAKE TË ALLAHUT -(SIFATI DHATIJE)	17
VUXHUD (EKZISTON)	18
KIDEM -“I PËRHERSHËM PA FILLIM”	18
BEKA -“I PËRHERSHËM PA MBARIM”	19
VAHDENIJET -“ALLAHU ËSHTË NJË”	19
KIJAMUN BINEFSIHI -“EKZISTON NGA VETVETIU”	20
MUHALEFETUN LIL HAVADITHI -“NUK I PËRNGJAN ASKUJT DHE ASGJËHIT”	20
CILËSITË KUPTIMORE TË ALLAHUT xh.sh. -(SIFATI MEANEVIJE)	21
HAJAT -“ALLAHU ËSHTË I GJALLË DHE I PËRJETSHËM”	22
ILM -“DIN GJITHÇKA”	22
SEM’Ë (DËGJON)	23
IRADE (I VULLNETSHËM)	23
KUDRET (I PLOTFUQISHËM)	25
KELAM -“FLET ME TË FOLURIT E TIJ HYJNOR”	26
TEVHID ESMA -“NJËSIMI I ZOTIT NË EMRA”	27
 KAPITULLI I DYTË	
EBU HANIFJA DHE ATEISTI	34
MËSUESI PA MEND	36
MËSUESI I MENQUR	37
BIJA E MENÇUR	38
BILALLI r.a.	39
IMANI – BESIMI NË ZOTIN	40
SURETUL – IHLAS	42

AJETUL KURSIJA	43
PĒRMBAJTJA	44

